

V E N D I M

Nr. 643, datë 14.09.2011

P Ë R

MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE SEKTORIALE TË SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie, në bashkëpunim me institucionet e përcaktuara në veprimet prioritare të saj.
3. Vendimi nr.706, datë 16.10.2003, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe të Sanitetit", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

SALI BERISHA